



KUVENDI I KOMUNËS–SUHAREKË
SKUPŠTINA OPSTINE - SUVA REKA
MUNICIPALITY OF SUHAREKA



PROCESVERBAL XII/2022

I mbajtur me rastin e mbledhjes së 12(dymbëdhjetë) për vitin 2022 të Kuvendit të
Komunës së Suharekës

Vendi: Suharekë
Zyra: Salla e Kuvendit të Komunës
Data: 29.12.2022
Ora: 10.00

Prezentë në takim:

Z. Shefket Kolgeci
Z.Selman Kolgeci
Z. Flamur Bytyqi
Z. Urim Suka
Z. Kushtrim Kuçi
Znj. Elmaze Bytyqi
Znj. Bulëza Kuçi
Znj.Doruntina Zenelaj
Z.Alban Berisha
Z. Bexhet Kuçi
Z. Reshat Selimaj
Z. Lirim Qatani
Z. Aziz Bytyqi
Znj.Sanie Kuçi
Rexhepaj
Znj.Mimoza
Bajrakatari
Znj.Fidaije Kukaj
Znj. Afërdita Morina

Znj.Saranda Bajraktari
Z. Driton Maliqaj
Z. Xhevshet Gashi
Z.Edon Sadikaj
Z.Dardan Berisha
Z.Bajram Basha
Znj.Mevlude Kabashi
Znj.Sheqerije Zyrapi
Znj.Laureta Tafaj
Z.Liridon Fandaj
Z.Qëndrim Elshani
Znj.Festë Kabashi
Z.Herolind Limaj
Znj.Jehona Rrafshi
Lumi

Të pranishëm të tjerë

Kryetari i Komunës
Media dhe qytetarë
OSCE, LMT, KDI
Znj.Habibe Bytyqi
Z.Xheladin Sadikaj

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Kryesuesi i Asamblesë Komunale z.Bexhet Kuçi,i cili i njoftoi me rendin e ditës.

Rend dite

1. **Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
2. **Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e planit të punës i Kuvendit të Komunës në Suharekë, për vitin 2023 dhe orari i mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, Komitetit për Politikë dhe Financa, dhe Komitetit për Komunitet për vitin 2023;**
3. **Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e planit vjetor të punës për Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) për periudhën janar-dhjetor për vitin 2023;**
4. **Pyetje dhe përgjigje;**

Urim Suka - përshëndet të pranishmit.Ne si kuvendar është tejet e rëndësishme që të ushtrojmë kompetencat tona për krijimin e kushteve më të mira për të gjithë.Për kundër që kemi pas vërejtjet tona e kemi votu kundër,kjo Asamble ka votu një listë të investimeve kapitale për vitin 2022,ku pastaj edhe janë zhvillu procedura tenderimi dhe janë lidhë edhe shumë kontrata për kryerjen e punëve në teren.Besoj është e rëndësishme për secilin prej nesh të dimë se sa janë përmbushur kërkesat qytetare dhe sa kjo listë e këto kontrata për investime kapitale janë përmbushur sipas planifikimit që ky Kuvend ka miratuar.Në emër të grupit të LDK-së kërkoj që të shtohet një pikë e rendit të ditës për formimin e komisionit verifikues për të parë nga afër se sa janë implementuar projektet që kemi miratuar në këtë Kuvend apo kemi pas anashkalim të Kuvendit dhe rrjedhimisht devijim të projekteve në teren.Qëllimi jonë është të formojmë një komision gjithëpërfshirës nga të gjitha subjektet dhe të vijmë në konstatime të përbashkëta me qëllim që një situatë e tillë të ndalohet për vitet në vijim sepse me këto veprime po shkaktohet dëm i konsiderueshëm i buxhetit të Komunës dhe po dëmtohen qytetarët tonë.

Kryesuesi - çdo anëtar i Kuvendit e ka të drejtën me kërku llogari në çdo kohë dhe ka të drejtën me dal në teren me verifiku çdo punë.Unë nuk e shoh të arsyeshme të formohet një komision por kërkesën tuaj e hedhim në votim.

Qëndrim Elshani - ne si grup i LVV-së e përkrahim kërkesën e LDK-së dhe i bëjmë thirrje asambleistave ta votojnë këtë pikë.

Dardan Berisha - siç e cekët, ne si asambleistë e kemi të drejtën e plotë me dal në teren dhe me shiku implementimin e të gjitha projekteve.Kërkoj sqarime nga zyrtari ligjor se sa kemi të drejtë ne me i formu këto komisione dhe për sa kohë do të vlejë ky komision.

Avni Bytyqi - realisht ligji e jep të drejtën që të themelohen komisione nga Kuvendi për çështje të caktuara.Ne në mandatet e kaluara kemi themelua komisione të natyrave të tilla por megjithëatë kanë kryer punën e vet dhe kanë mbet ashtu.Nuk ka pas ndonjë efekt juridik tutje.Në mbledhjet e rregullta kur propozohen pikat e rendit të ditës, ligji e thotë që pika e cila propozohet duhet të jetë e karakterit urgjent. E përcakton nëse është e karakterit urgjent vota e anëtarëve të Kuvendit.

Urim Suka - unë jam i befasuar me qëndrimin e Kryesuesit.Unë e di si është gjendja në teren dhe vazhdimisht i kam ngrit temat deri tash.Unë kërkoj ta bëjmë një komision bashkë dhe ta verifikojmë gjendjen në teren. Qëllmi është me pa çka ka ndodhë dhe mos mi përsërit gabimet.Komisioni ka mandat një muaj apo dy,deri sa ta përmbyll punën.

Dardan Berisha - cili është roli jonë vendimmarrës pastaj? Në këtë rast,ne mundemi me kërku raport prej Drejtorit të Shërbimeve Publike për çdo implementim të çdo projekti.Në kuadër të planit të punës për vitin 2023,unë kam kërku që Drejtoria e Arsimit me pas një raport brenda 6 muajve ose një viti.Është e vështirë me dal në 42 fshatra por besoj që secili në terrenin ka gravitojmë mundemi me kry punën tonë.

Aziz Bytyqi - çdo kërkesë është legjitime por çështja është se a është e nevojshme. Ne si anëtar të Kuvendit e kemi mandatin edhe nga qytetarët por edhe ligjor që të merremi me çdo shqetësim të qytetarëve.Ne ato

projekte mund ti analizojmë,ti ngrisim shqetësimet në drejtoritë përkatëse.Ne me formu komision për një çështje që ne veq e kemi të drejtën dhe me kërkim autorizim shtesë prej Kuvendit ,efekt praktikë nuk ka.Për deri sa nuk ka efekt praktikë s'kam se si e mbështes dhe këtë e them në emër të grupit.

Urim Suka - unë jam i befashuar me fjalët e Azizit dhe nuk besoj që Azizi e përfaqëson atë që e tha.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën shtesë për rend dite.

13 për, 14 kundër, 1 apstenim
Nuk hyn në rend dite pika shtesë

Kryesuesi - e hedh në votim rendin e ditës.

16 për, 12 apstenime
Miratohet rendi i ditës

Pika 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Kryesuesi - pyet se a ka vërejtje në procesverbal.

Jehona Rrafshi Lumi - pyetja që është bërë lidhur me rendin e udhëtimit, është cekur rregullorja e vitit 2018,ku kjo rregullore është miratuar me 26 dhjetor dhe jo me 36 dhjetor siç është cekur në procesverbal.

Kryesuesi - është gabim teknik.Kryesuesi e hedh në votim pikën 1 me vërejtjen që u tha.

Unanimisht Miratohet

Kryesuesi - Kryesuesi raporton në pika të shkurtra rreth mbajtjes së seancave dhe vendimeve që janë marrë dhe thotë:gjatë këtij viti organi legjislativ,si organi më i lartë ka mbajtur 13 mbledhje,ku prej tyre një ka qenë e jashtëzakonshme ndërsa të tjerat kanë qenë mbledhje të rregullta.Po ashtu KPF ka mbajtur 12 mbledhje dhe Komuniteti për Komunitetet ka mbajtur 12 mbledhje.Gjatë këtij viti është miratuar statuti i QKMF-së si një dokument mjaft i lartë juridik, poashtu është miratuar Harta Zonale e Komunës si një dokument i rëndësishëm për gjithë territorin e K.Suharekës.Janë miratuar gjithsej 54 vendime dhe të gjitha këto akte nënligjore të Komunës janë dërguar në MAPL për shqyrtim dhe harmonizim të ligjshmërisë dhe deri më tani kemi patur dy rekomandime.Që të dy rekomandimet në afatin ligjor i kemi zbatuar.Të gjitha obligimet që rrjedhin nga ligji për vetqeverisje lokale,statuti i Komunës dhe rregullorja e punës së Kuvendit,i kemi përmbushur.Andaj ju falemnderoj për kontributin e dhënë si anëtar të Kuvendit për bashkëpunimin e frytshëm dhe ndërsjelltë që kemi patur gjatë vitit 2022 dhe ju uroj festat të gjithëve.

Pika 2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e planit të punës i Kuvendit të Komunës në Suharekë, për vitin 2023 dhe orari i mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, Komitetit për Politikë dhe Financa, dhe Komitetit për Komunitet për vitin 2023;

Kryesuesi - elaboron pikën 2 dhe hap debatin.

Flamur Bytyçi - bazuar në nenin 12 të ligjit nr. 03/ L – 040 për Vetqeverisjen Lokale,në emër të grupit të LDK-së propozoj që në agjendën e planit të punës të Kuvendit Komunal Suharekë për vitin 2023 të formohen komisione për secilën drejtori të cilët do të përfaqësohen nga anëtarët e Kuvendit të të gjitha subjekteve politike.Gjithëashtu mandati i tyre të jetë i barabartë me mandatin e kësaj legjislature.Qëllimi i formimit të këtyre komisioneve është që të rritet transparenca,të ketë raportim nga ana e drejtorëve së paku 3 herë në vit.Kërkoj nga anëtarët e Kuvendit që ta përkrahin këtë kërkesë.

Qëndrim Elshani - po e shoh që nuk ka ardh drejtori i Urbanizmit i cili sipas planit të punës do të duhej ta mbyllte vitin me raportim për zbatimin dhe monitorimin e PZHK-së.Gjithëashtu dua ti bëj një pyetje se me çfarë procedure janë kryer dy apo më shumë zona prej banimit individual që i kemi parapa në Hartë Zonale në banim me shumë njesi, ku edhe kërkesat e komisionit janë refuzu. Sido çoftë mosprezenca e tij do të thotë heshtje dhe heshtja flet.

Kryesuesi - e hedh në votim propozimin e Flamurit se a duhet të futet në plan të punës formimi i komisioneve apo jo.

**12 për, 16 kundër
Nuk Miratohet**

Kryesuesi - e hedh në votim pikën e dytë.

**16 për, 4 kundër, 8 apstenime
Miratohet pika 2**

Pika 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e planit vjetor të punës për Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) për periudhën janar-dhjetor për vitin 2023;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

Alban Berisha - Vetëdijësimi për rrezikun e përdorimit të mjeteve piroteknike ka qenë vjet në plan të punës por është edhe këtë vit. Mjetet piroteknike janë duke u keqpërdorur me të madhe dhe e di që është kompetencë e policisë por ju Kryetar, si Kryesues i atij këshilli, çfarë masa keni ndërmarrë ose çka keni planifikuar me ndërmarrë? Gjithëashtu edhe për identifikimin e vendeve ku dyshohet se të rinjtë tonë përdorin substanca narkotike. A janë dy pika që duhet me qenë në dokument apo janë dy pika që e keni marrë me seriozitet sepse për ne këto janë dy dukuri shumë shqetësuese.

Kryetari - ne kemi pas takim javën e kaluar me KKSB-në dhe kemi marrë vendim që shitja e tyre të bëhet te tregu javor me një afat prej një javësh, mirëpo ju e dini se kompetencë e kujt është. Për çështjet tjera sa i përket sigurisë, është e vërtetë që është kompetencë e policisë por edhe ne do të mundohemi. Sipas raportimeve të policisë në KKSB, këtë vit ka më pak raste se vitin e kaluar.

Alban Berisha - e di që ne si Komunë nuk e kemi kompetencë me ndalu importimin e tyre por të paktën me ndiku sepse asnjëri prej tyre nuk është shitës i autorizuar dhe kjo është kompetencë e Komunës. A ka ndonjë kontroll se a mundet një fëmijë me shku me ble? Nëse prindi ia blen, të paktën e merr dikush përgjegjësinë. Më vje keq sepse ndoshta dikush prej tyre e mban familjen por unë po flas në të mirë të sigurisë së fëmijëve. Këtë të paktën mund ta bëjmë.

Avni Bytyqi - siç e tha dhe Kryetari, ne me datë 14 kemi pas takim me KKSB-në. E kemi trajtuar disa here çështjen e mjeteve piroteknike dhe vazhdimisht e trajtojmë. Ju njoftoj se FSK-ja si organ kompetent vazhdimisht përmes Drejtorisë së Arsimit bëjnë kërkesë dhe ne ju mbajmë ligjerata nxënësve dhe fëmijëve nëpër shkollat për çështjet e rrezikut të mjeteve piroteknike si dhe mjeteve të pashpërthyer. Zyryari ligjor jep sqarime edhe rreth çështjes së shitjes së mjeteve piroteknike.

Dardan Berisha - kur kemi te analiza e vjedhjeve në territorin e Komunës së Suharekës, kjo dukuri është e pranishme në 12 muaj dhe jo vetëm në muajin prill siç është analizu. Te trajtimi dhe mbrojtja e pyjeve nga dëmtuesit ilegal, edhe kjo është çështje që duhet me pas parasysh 12 muaj. Po e shoh që nuk e keni trajtuar çështjen e trajtimit të qenëve endacak.

Avni Bytyqi - ju e keni rekomanduar në KPF dhe ne e kemi futur në plan të punës.

Urim Suka - unë nuk e kuptova Kryetarin se pse orientimin e kaloi te Avniu. Shqetësimi i Albanit ishte i drejtpërdrejtë. Ju keni marrë vendim por në teren tjetër gjë po zbatohet.

Kryetari - falemnderon të pranishmit për bashkëpunimin dhe u uron festat e fundvitit të gjithë qytetarëve.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 3.

Unanimisht Miratohet

Pika 4. Pyetje dhe përgjigje;

Shefket Kolgeci - ia uron Vitin e Ri të gjithëve. Është një traditë që zakonisht në fund të vitit caktohet një datë dhe shpallen sportistat e vitit. Sikur të ishte caktuar një datë dhe të na kishit ftuar, të paktën disa kishin

ardhë por Kryetari nuk e ka bërë këtë gjë dhe ne si asamble, unë personalisht nuk jam në dijeni se kur dhe kush është zgjedhur sportisti i vitit. Kjo është një vërejtje për Kryetarin. Ne si Asamble të paktën një ftesë e kemi meritë.

Urim Suka - kam një shqetësim të furnizimi me energji elektrike dhe e di që pjesën e përgjegjësive, që ekzekutivi komunal nuk mundet me ndiku shumë. Unë po kërkoj që ju si Komunë të shihni këto probleme. P.sh. në lagjen "Suka" ka katër ditë që nuk kemi furnizim e po ashtu edhe në shumë vendbanime tjera. Kërkoj nga ju që ti adresoni këto shqetësime të qytetarëve dhe në formë të kërkesës ti dërgoni te KEDS dhe ti bëni një lloj presioni sepse jemi në dimër dhe është shumë shqetësuese. Kam shqetësim edhe te Grejkoci, ku ju e keni bërë një kontratë për ndërtimin e rrugëve në Grekoc dhe rruga "Nuh Halimi dhe Bajram Sylja" janë në kontratë dhe asnjëra nuk është e shtruar. Kërkoj sqarim për këtë. Shqetësim tjetër kam te kontratat që keni ndërlidhë për ndërtimin dhe sanimin e rrjetit të kanalizimit. Mbi 500 mijë euro keni kontratë kanalizimi dhe në secilin vendbanim keni probleme me kanalizim. Kërkoj nga Drejtorja e Shërbimeve Publike që nëse është mundësia që për seancën e ardhshme ta përgadis një raport detaj të këtyre dy kontratave se në cilat vendbanime kanë shkuar, në cilat kanalizime, cilat rrugë të reja janë shtruar dhe në cilat rrugë është bërë sanimi. Është e pa shpjegueshme për mua, ku keni një kontratë për sanimin dhe instalimin e ndriçimeve publike. 50 % e ndriçimit publik në Bllacë nuk funksionon. Edhe për këtë kërkoj një raport se në cilat vendbanime janë bërë ndriçime të reja dhe në cilat vendbanime ka pas sanime. Projekti te Kolektori i rrugës "Skënderbeu" ka dështuar. A ka mundësi me përgadit një raport për ato parë që kanë qenë të zotunë për Kolektorin e rrugës "Skënderbeu" se në çfarë projekte janë shpërndarë?

Kryetari - ju e dini që ne sipas ligjit në fuqi i lëshojmë parcelat për vendosjen e trafave dhe çdo kërkesë e banorëve që ka ardhë, ne e bëjmë direkt në Prishtinë. Është e vërtetë që kohën e fundit kemi pas probleme të mëdha dhe tri herë kërkesa zyrtare kemi bërë por nuk kanë ardhë. Kolektori nuk ka dështuar. Vazhdojmë rrugën e Reshtanit me punë, është lënda në OSHP dhe kur të vendos organin, ne kemi me vazhdu me punë.

Selman Kolgeci - pyetje për Drejtorin e Shërbimeve Publike: iu kam drejtuar zyrtarisht me një email ku kam kërkuar që ta përgadisni listën e investimeve kapitale dhe vendimin për caktimin e menaxherëve të kontratave. Sinqerisht jam zhgënjyer nga përgjigjja aspak profesionale. Qasja që keni tregu dhe po tregoni, jo vetëm ju por edhe kolegët tjerë në raport me prezantimin e dokumentacioneve të tilla, është indeks i qartë i mungesës së transparencës që ka kjo qeverisje. Këtu më herët e thatë që asambleistat kanë të drejtë me kërkuar qasje dhe me dalë me të verifikuar por ja ku e kemi një rast që nuk na është lejuar qasje. Kërkoj që ta kompletini dokumentacionin që kam kërkuar bazuar në ligjin për qasje në dokumente publike. Kërkoj që të kemi një kopje të listës së kontratave të vitit 2022 dhe atyre aktive të vitit të kaluar.

Pyetje për Kryesuesin: Bordi i drejtorëve të stacionit të autobusave ka shpallur dy konkurse të ndryshme për rekrutimin e dy drejtorëve të bordit të stacionit ndërsa në dokumentacionin që më është siguruar nga kjo ndërmarrje, rezultoi se janë rekrutuar tre aplikues dhe atë për shpalljen e rezultateve është përdorur vula e stacionit ndryshe nga thirrja për aplikim që është përdorur vula e Komunës si aksionar i kësaj shoqërie aksionare. Si kanë ndodhur këto lëshime? A jeni në dijeni për këto veprime dhe a keni informacione se aty njëri prej anëtarëve të komisionit vlerësues dyshohet se ka konflikt interesi me njërin nga aplikantët që figurojnë në listën e atyre që janë pranuar në punë? Stacioni i autobusëve po pëson humbje të mëdha nga mos inkasimi i mjeteve nga penalizimi i autobusave. Rreth 30 % ka humbje tre muajt e fundit stacioni i autobusave nga autobusat që nuk hynë fare në stacion. A keni strategji se si të evitoni këto humbje? Nëse jo, filloni ndërtone një strategji të tillë. Drejtoresha e Inspeksionit nuk po ka guxim të ndalojë asnjë ndërtim pa leje që po ndodhin, e ndoshta për këtë temë ka guxim të veprojë. Qështja që më shqetëson dhe duhet të marrë përgjigje nga ju Kryesues apo zyrtari ligjor është: a kanë të drejtë të paguhet drejtorët e bordit të stacionit edhe pas skadimit të mandatit të tyre? Në dokumentacionin që e posedoj, posedon se ka vazhduar pagesa për dy nga anëtarët e bordit edhe pas përfundimit të mandatit. Meqenëse kjo ndërmarrje nuk ka një përmirësim të gjendjes ekonomike të saj, unë kërkoj që të shkarkohet bordi i ndërmarrjes. Pyetje për Kryetarin: në raport të punës ka thënë që do të raportoj në mars Kuvendit për punën e vitit 2022 ndërsa unë kam prit që këtë seancë do të raportojë. Dua të kujtoj disa nga dështimet e tij që janë kundërthënëse me ato që po i thotë nëpër media. Shtëpia e kulturës "Ukë Bytyçi" po vazhdon të zvarritet si pasojë e paafetësisë të kësaj qeverisjeje ku para një muaji e keni anuluar tenderin për fazën e dytë. Ju dhe Drejtorja e Kulturës nuk keni treguar as respekt për artistët e as më të voglin angazhim lidhur me plotësimin e rekomandimeve të cilat i

ka vendosur komisioni i caktuar nga Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit lidhur me themelimin e teatrit. Devijim të listës së projekteve, cilësi skajshmërisht të ulët të punimeve në pjesën dërmuese të projekteve kapitale, mungesë të investimeve në impiante për Pastrimin e ujrave të zeza, shpenzim i rreth 1 milion eurove të taksave të qytetarëve për pagesat e vendimeve gjyqësore për mësimdhënës. Drejtor që bëjnë punën e gjyqtarit duke lejuar të zhvillohen punime në prona private me pretekstin se dihet se si do të përfundon vërtetimi i pronësisë në fjalë, drejtor që dyshohet se keqpërdorin pozitën e vet, emrin e institucionit për të shantazhuar e kërcënuar qytetarin, pagesë nga taksat e qytetarëve për punonjës të cilët nuk shkojnë në punë e as nuk jetojnë në Kosovë por në fund të muajit e marrin rrogën sikur të ishin në vend pune. Sërisht jeni renditur në top 10-shen e autoriteteve ndaj të cilave është bërë ankesë në organin shqyrtues të prokurimit. Unë për dështimin e drejtorëve nuk mund të kërkoj ti shkarkoni drejtorët por po të kërkoj që ti së bashku me ta, ta dorëzoni mandatin.

Kryetari - mandatin e dorëzojmë të shtunën dhe kur të fillon Viti i Ri vazhdojmë.

Enver Shabani - për pyetjen që ke bërë z. Kolgeci ju keni marrë një përgjigje me shkrim nga ne. Ju e dini shumë mire që Drejtoria e Shërbimeve Publike nuk lidh asnjë kontratë me asnjë operatorë ekonomikë dhe nuk jep asnjë vendim për menaxhimin e kontratave. Vendimet për caktimin e menaxherëve, për udhëheqjen dhe mbikqyrjen e kontratave i bën zyra e Kryetarit së bashku me zyrën e prokurimit kurse kontratat i lidh zyra e prokurimit ndërsa drejtoria jonë i bën vetëm paramasat dhe paralogaritë, i dërgon në zyrën e prokurimit dhe nuk kemi më asnjë përgjegjësi, vetëm nëse na caktohet ndonjë vendim për menaxhim të kontratës, ne e menaxhojmë deri në fund atë kontratë. Sa i përket pyetjes së z. Suka për fshatin Greikoc, kontrata është dy vjeqare dhe vitin e ardhshëm do të përfundojnë ato rrugë që cekët.

Selman Kolgeci - lexon kërkesën me të cilën iu është drejtuar Drejtorisë së shërbimeve Publike dhe thotë që nuk ka asgjë të paqartë. Kam thënë: nëse e ke vetëm një kontratë, atë sjelle. Dhe prap e kërkoj listen që ju jeni duke e mbikqyr.

Urim Suka - drejtor, nuk më dhe përgjigje. Unë e kam kontratën dhe kontrata thotë: kontarta hyn në fuqi me datë të nënshkrimit 17.05.2022 dhe përfundon Brenda 90 ditë pune dhe kjo i ka kalu 90 ditë pune. Rruga "Hut Halimi" dhe rruga "Bajram Sylja" a janë të shtruara?

Enver Shabani - Selman mos prit nga ne një përgjigje të tillë që e kërkon. Një draft raport e kemi bërë dhe është i protokolum. Komplet raportin mundemi me ju dërgu secilit prej jush.

Selman Kolgeci - unë i kam kërku kontratat të cilat i menaxhon apo mbikqyr drejtoria juaj. Nëse nuk përgjigjesh ka me adresu te avokati i popullit.

Kryesuesi - sa i përket pyetjeve rreth stacionit të autobusave, pyetja e parë ishte rreth konkursit, ku faktikisht kanë qenë dy konkurse dhe rasti është duke u trajtu në antikorrupsion dhe për deri sa nuk marrim një përgjigje prej antikorrupsionit, unë nuk mund të jap sqarime. Sa i përket mos hyrjes së autobusave në stacion të autobusave, është fakt që një pjesë e tyre nuk hyn në stacion dhe arsyetohen për konflikte në mes kompanive. Kjo është shqetësuese mirëpo këtë çështje Drejtoria e Inspeksionit duhet ta ketë parasysh dhe duhet të dal dhe ti obligoj autobusat që të hyjnë në stacion. Ndërsa sa i përket pagesave për dy anëtarët e bordit, unë e kam bisedu me kryeshefin ekzekutiv dhe kam kërku sqarim por ai është bazu që dikun ka pas të drejtë. Kam kërku sqarim me shkrim se ku ka pas të drejtë mirëpo nuk më ka kthyer sqarime, dhe në moment i ka ndërpre pagesat. Është një çështje që duhet të ngritet.

Avni Bytyqi - si zyrtar ligjor jep sqarime dhe thotë që nuk lejohet të bëhet pagesa mbas përfundimit të Mandatit.

Reshat Selimaj - z. Kolgeci, ju keni kërku takim dhe unë të kam prit. Ti kam argumentu faktet që kemi pas bazë ligjore deri sa të formohen anëtarët tjerë të bordit të ri. Sa i përket inkasimit kemi kërku që të vedoset një tabelë te Podrumi, që të bëhet rruga e obligueshme dhe të hynë në qendër dhe të shkojnë përball stacionit. Tabela është heq dhe unë prap kërkoj që të vendoset.

Selman Kolgeci - sa i përket bazës ligjore konsultoj me zyrtarin ligjor dhe sillni faktet. Te çështja e shenjës, unë nuk e di që është heq dhe nëse është heq kërkoj të vendoset prap.

Flamur Bytyçi - kërkoj ta di nga Drejtoresha e Inspeksionit se pse s'ma ka dorëzuar raportin mbledhjen e kaluar.

Albulena Kokollari - është e vërtetë që keni kërku raport por herën e kaluar ju keni munguar dhe s'kam pas si me ta dërgu raportin.

Flamur Bytyqi - keni mundur ta dërgoni me email ose ta sillni këtë seancë.

Albulena Kokollari - nuk e keni kërku me email dhe sot nuk e kam me vete.E kam dorëzuar raportin vjetor dhe shumë shpejt ka me dal në web faqe.

Dardan Berisha - pyetje për Drejtorinë e Arsimit: mundësia e lidhjes së një kontratë me ndonjë operatorë për bartjen e nxënësve prej lagjes “Hoxhaj” te shkolla në Budakovë, nëse është mundësia.Pyetje për Drejtorin e Shërbimeve Publike:deri ku ka shkuar projekt-vendimi që e kemi marrë në Kuvend në 30 mars për themelimin e një ndërmarrje publike “Eko Theranda” ?Kush është kontraktori fitues për mirëmbajtjen e rrugëve? Pyetje për Drejtorinë e Urbanizmit: kur do të fillojë faza tjetër e emërtimit të rrugëve? Sa leje ndërtimi janë lëshuar deri në këtë periudhë nga hyrja në fuqi e PZHK-së dhe HZK-së?

Kryetari - është e vërtetë që e kemi bërë kërkesën zyrtare për formimin e një ndërmarrje Komunale dhe momentalisht prej 6 Komunave e ka fitu vetëm Podujeva.E kemi bërë dhe një ankesë dhe presim përgjigje pozitive.

Remzi Bajselmani - ne jemi të informuar me kërkesën e banorëve të lagjes Hoxha.Jemi përpjek me bo marrëveshje me një operatorë në atë teren dhe nuk kemi mundur të gjejmë kompromis.Tani jemi në procedurë dhe deri më 8 shkurt janë duke u zhvilluar procedurat për këtë lagje.

Enver Shabani - ka mirëmbajtje dimërore dhe para disa dite është lidhë marrëveshja me kompaninë Famis.

Visar Kuçi - sa i përket adresave,ne e kemi nënshkruar një memorandum bashkëpunimi me agjencionin kadastral,është donacion i bankës botërore dhe vitin tjetër ka me fillu.Sa i përket lejeve ndërtimore,prej hyrjes në fuqi të HZK-së e kemi lëshuar një leje dhe kushte ndërtimore rreth 20.

Kushtrim Kuçi - pyetje për Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Kryetarin: përpos që është vlera e madhe dhe e dështuar si projekt, a keni pa dikun kanalizimi mu vendos mbi dhe! E kam ngrit këtë shqetësim dhe është në Krushicë të Poshtme.Këto projekte që realizoni,a keni mbikqyrës,a merrni përgjegjësi dhe si ka mundësi me ndodh ky fenomen?Kjo është shumë shqetësuese.

Kryetari - është e vërtetë dhe ke të drejtë por për fat të mirë këtu ka qenë një komision i fshatit.Ka menaxher, ka mbikqyrës dhe ata që nënshkruajnë gabimet, e kanë përgjegjësinë.

Jehona Lumi Rrafshi - falemderoj qytetarët për bashkëpunimin, gjithëashtu falemderoj grupin e grave asambleiste, nënkryetaren, drejtorat dhe ju Kryetar, të cilët nuk keni hezitur që shumë çështje ti ngrisim dhe ti shtym përpara për të mirën e qytetarëve të Komunës së Suharekës.Në e emër të partisë Nisma Social Demokrate dhe në emrin tim, të gjithë qytetarëve të K. Suharekës ia uroj festat e fundvitit.

Urim Suka - falemderoj secilin prej jush për durimin që keni tregu gjatë këtij viti për me më ndëgju.Në emër të LDK-së ju uroj të gjithëve një vit sa më të mbarë.

Qëndrim Elshani - me datë 27 dhjetor ka përfunduar kontrata në mes K.Suharekës dhe operatorit ekonomikë, ku për gjatë 10 viteve e ka pas të drejtën ekzekutive të shfrytëzimit të hapsirës publike për vendosjen e reklamave. A po i bie që gjithë qytetarët dhe bizneset që kanë marrëveshjen aktuale me këtë operatorë ekonomikë, nuk kanë obligime financiare ndaj tij.Pse nuk është hap ende kjo thirrje? Pyetje drejtuar Drejtoreshës së Kulturës nga djemtë e qytetit të njohur si “Xhebrailat”: Çfarë inati ka drejtoresha me ta? Para disa dite janë nda çmimet e sportistëve të vitit, ku Xhebrailat nuk kanë marrë asnjë çmim.

Kryetari - është e vërtetë që ka skaduar afati i reklamave dhe kemi vendos që të shpallet në muajin janar.

Lorika Gashi - sportisti i vitit është mbajtur me 27 të këtij muaji.Ka qenë kërkesë e zëshme e sportistave: të lutem mos e politizoni sportistin e vitit dhe mos bjerni asambleista dhe drejtora.Andaj nuk ka pas ftesë speciale për askënd dhe ju kërkoh falje. Sa i përket rekomandimit të Qëndrimit,.Xhebrailat kanë qenë të ftuar dhe kanë pas gjithmonë mirënjohje,por qëndrimi i tyre politik ndoshta, nuk më takon mua me e zbut këtë çështje.I kam thirrë dhe kam pas takime vazhdimisht me ta dhe me ju tregu që çka do që kanë kërkesë nuk kanë nevojë me dal me statuse ofenduese ndaj klubeve.

Qëndrim Elshani - sa i përket politizimit të xhebrailave, unë e thash që nuk duhet me politizu, andaj kisha kërku edhe ndaj teje mos me politizu.Sa i përket ristrukturimit të tyre,ata e din më mirë se kush duhet me qenë n’struktura udhëheqëse të tyre dhe kush jo.Unë nuk jam kompetent se kujt duhet ti jepet mirënjohje,mirëpo unë kam ardhë me kërkesë të tyre për anashkalimin që i është bërë,që nuk i keni ftu.

Lorika Gashi - i kam ftu si të gjithë tjerët dhe mirënjohjen e kam.

Dardan Berisha - realisht shqetësimin që e ngriti Qëndrimi është me vend. Arsyetimin që dha drejtoresha, mua personalisht më duket e pa arsyeshme dhe ju e keni për obligim me thirrë. Shumë projekte për sportista i kemi kalu këtu sepse buxheti ndahet prej votës tonë.

Shefket Kolgeci - rregullat e drejtorisë, rregullat e Komunës nuk duhet me ra pre e dikujt. Besojmë që herave tjera nuk do të gaboni.

Lorika Gashi - nuk e kam vendos vetëm unë. E kemi vendos bashkë me komisionin dhe drejtorinë.

Alban Berisha - në organizime të tilla, të paktën Kryesuesi me dhanë një çmim sepse na përfaqëson të gjithëve. Ju kisha lut me pas kujdes te ndarja e çmimeve.

Lorika Gashi - unë nuk kam qenë pjesë e komisionit dhe për herë të parë ka qenë një komision me vendim dhe kanë qenë katër profesor të sportit dhe një gazetar.

Kryetari - është bërë një lëshim. Jemi mundu me bo një komision që janë jashtë nesh, por gjatë punës bëhen edhe gabime. Doktor, keni plotësisht të drejtë. Nuk veten klubet dhe kisha pas dëshirë që kur të ju ftojme, me na ardhë.

Takimi përfundoi: 11:45

Procesmbajtësja:
Dafina Haziraj